



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, 12 tetor 2011, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Bahri Thaçi, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca dhe Aurora Bakalli.

Munguan: Flora Brovina dhe Salihe Mustafa

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës së shëndetësisë, Shefki Kastrati - NDI, Ukë Gashi - Presidenca e Kosovës, Floriana Shala – OSBE.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 7. 9. 2011;**
- 3. Raportimi i grupeve të punës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 7. 9. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e datës 7 shtator 2011.

3. Raportimi i grupeve të punës

Fikrim Damka - Ne si komision i kemi formuar dy grupe të punës, njërin për monitorimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe tjetrin për amendamentimin e Projektligjit për statusin dhe për të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre.

Nazane Breca - Në cilësinë e kryesueses së grupit të punës për monitorimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës, deklaroi se janë duke punuar në përputhje me planin e punës për monitorimin e këtij Ligji. Kemi vizituar MPMS-në, ku jemi takuar me sekretarin e përgjithshëm dhe me drejtorin e Zyrës Ligjore. Nga takimi doli konstatimi se do të ishte mirë të hartohej një ligj i ri për Inspektoratin e Punës, sepse ligji i tanishëm ka shumë mangësi dhe është miratuar para shumë kohësh dhe është vështirë i zbatohet. Po ashtu jemi takuar edhe me kryeinspektorin e Punës. Sipas tij inspektorët hasin në vështirësi gjatë zbatimit të këtij Ligji. Kanë mungesë të madhe të inspektorëve të Punës dhe nuk mund ta kryejnë punën e tyre sipas ligjit.

Sipas planit, javën e ardhshme do t'i vizitojmë disa komuna, si: Prizreni, Gjakova, Ferizaj, Prishtina, si dhe disa ndërmarrje.

Time Kadriaj - Konstatoi se është bërë një punë e madhe nga të gjithë në amendamentimin e këtij Projektligji. Përveç edhe disa konsultave që do të duhej t'i bënin me shoqatat e dala nga lufta, eventualisht edhe me Ministrinë e Financave, pothuajse e kemi të gatshëm këtë Projektligj me amendamente. Nuk po e kuptojmë përse nuk është caktuar për këtë javë takimi i grupit të punës nga kryesuesja, Flora Brovina.

Fikrim Damka - Duhet ta shpejtojmë punën për miratimin e këtij Projektligji në Komision.

Aurora Bakalli - Deklaroi se është e njohur se kategoritë e dala nga lufta dëshirojnë që edhe veteranët të jenë të përfshirë brenda këtij Projektligji. Ne me amendamente i kemi futur ata në kuadër të këtij Projektligji, duke e vendosur si datë të fillimit të aplikimit të pensioneve personale për ta 1 janarin e vitit 2015. Dëshirë jona është që ta miratojmë një ligj që është i zbatueshëm dhe njëkohësisht t'i përmbushë kërkesat e kategorive të cilave u dedikohet ligji.

Bahri Thaçi - Tha se jemi të interesuar që brenda këtij Projektligji t'i përfshijmë të gjitha kategoritë e dala nga lufta. Gjithashtu jemi të interesuar të mos konfrontohemi me organizatat ndërkombëtare financiare. Duhet ta miratojmë një ligj, i cili do të jetë funksional dhe i zbatueshëm. Kryesuesja duhet të komunikojë me zyrtarët e Qeverisë, me qëllim që ky Projektligj të mos stagnojë.

Time Kadriaj - Vlerësoi se me këto amendamente nuk e kemi ngarkuar financiarisht Qeverinë, sepse të gjitha përfitimet për veteranët i kemi shtyrë për vitin 2015 dhe kjo kohë është e mjaftueshme.

Nazane Breca - Tha se si grup kemi menduar se nëse hiqen veteranët nga ky Projektligj, Projektligji nuk do të jetë i plotë dhe përsëri do të kemi probleme.

Fikrim Damka - Propozoi që si komision të takohemi me ministrin e Financave, për t'i qartësuar të gjitha dilemat që i kemi rreth këtij Projektligji.

Komisioni vendosi që ta ftojë në takim të Komisionit ministrin e Financave.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka - I informoi anëtarët e Komisionit për takimin e mbajtur me kryetarin e Shoqatës së Pensionistëve. Ata i kanë shfaqur shqetësimet e veta lidhur me Ligjin e pensioneve. Propozoj ta ftojme në takim të Komisionit ministrin e MPMS-së, z. Nenad Rashiq, për të diskutuar për këto çështje.

Komisioni vendosi ta ftojë në takim të Komisionit ministrin e MPMS-së, z. Nenad Rashiq.

Sasha Rashiq - Propozoi që në kuadër të vizitave që bëhen nëpër komuna për monitorimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës, të vizitohet një nga komunat e reja, si p.sh: Graçanica apo Shtërpca.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka